



ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ

Υπουργείο Μετανάστευσης & Ασύλου

Athinë më 19 Tetor 2020

## DEKLARATË PËR SHTYP

### **Përmirësohet platforma elektronike e Shërbimit të Azilit-Ekskluzivisht me takim në mënyrë elektronike shërbimi për publikun.**

Ministria e Emigracionit & Azilit përmirëson me shërbime të reja portalin dixhital ([applications.migration.gov.gr](https://applications.migration.gov.gr)). Nga nesër, e Martë, më 20.10.2020, u jepet mundësia azilkërkuesve të mbyllin takimet e tyre në mënyrë elektronike dhe theksohet se në vijim shërbimi i Azilit do të kryejë shërbimet për publikun **ekskluzivisht dhe vetëm pasi të jetë caktuar takim në mënyrë elektronike.**

Tashmë, ekskluzivisht me përcaktim takimi, kryhen:

- Intervista të programuara
- Regjistrime të programuara
- Depozitim dokumentesh në lidhje me çështje të bashkimit familjar(çështje Dublini)

Në mënyrë të veçantë, lejohet depozitimi i apelimit pa përcaktuar takim, për arsye afatesh detyruese.

Ndërkohë shumë shërbime kryhen në mënyrë elektronike, nga Qershori i 2020 pa qenë e nevojshme të paraqiten personalisht ,si:

- Ndryshimi i të dhënave të komunikimit,
- Ndryshimi i të dhënave të identitetit,
- Kërkesë për pezullim/ përsheptim të intervistës,
- Vërtetim për fazën e kërkesës,
- Vërtetim për veçim dosjesh,

- Vërtetim për depozitim dokumentesh,
- Vërtetim për dhënie kopjesh,
- Kërkesë për ndihmë ligjore,
- Kërkim i PAAYPA.(Nr.i Përkohshëm i Sigurimeve për Kujdesin Shëndetësor)

Gjithashtu, për uljen e mbingarkesës së shërbimeve, vlefshmëria e kartave të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare(triptik) është shtyrë nga dt. 2 Nëntor 2020 deri më 14 Janar 2021, në varësi të shifrës së fundit të numrit të çështjes së tyre.